

platforma

**CiviKos**



# Buletini 11

**Tetor - Dhjetor 2016**

## Shoqëria Civile adresoi çështjet me interes për sektorin tek Kryeministri Mustafa

Sot me datë 21.11.2016 Platforma CiviKos organizoi konferencën rreth bashkëpunimit të shoqërisë civile dhe Qeverisë. Në të morën pjesë z. Isa Mustafa, Kryeministër i Republikës së Kosovës, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, të organizatave ndërkombëtare, të Këshillit për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile, zyrtarë të Qeverisë së Kosovës, aktivistë të shoqërisë civile dhe Mediave. Gjatë këtij takimi, Shoqëria Civile adresoi çështjet me interes për sektorin tek Kryeministri Mustafa.

Kryeministri Mustafa ishte i ftuar të bashkëbisedojë me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile rreth bashkëpunimit shoqëri civile - qeveri. Në fillim të kësaj konference, Drejtoresha e Platformës CiviKos znj. Valdete Idrizi theksoi se Kosova është duke u ballafaquar me probleme të mëdha, në fusha të ndryshme, ku shoqëria civile në mënyrë të vazhdueshme është duke ngritur zërin, qoftë përmes protestave apo avokimit. Idrizi shtoi që bashkëpunimi mes sektorit të shoqërisë civile dhe Qeverisë poashtu është i një rëndësie të veçantë. Bashkëbisedimi i sotëm me Kryeministrin Mustafa u fokusua tek çasja e qeverisë ndaj sektorit të shoqërisë civile, si dhe problemet që organizatat ballafaqohen karshi këtij institucioni. Çasja selektive e disa ministrive në raport me organizatat e shoqërisë civile në përfshirje, ndarja jo-transparente e fondeve publike për organizata, mungesa adekuate e konsultimit publik, etj, ishin disa nga temat që u adresuan në mënyrë të drejtpërdrejt tek Kryeministri.

Përveç bashkëpunimit në përgjithësi, me theks të veçantë u trajtuan disa nga sfidat dhe problemet në zbatim të Strategjisë Qeveritare si: neglizhenca e përfaqësuesve të Qeverisë në Këshill, çasja jo-serioze ndaj sektorit, vonesat në zbatim të Strategjisë, mos-ndarja e buxhetit nga Qeveria për zbatim të Strategjisë, etj. Përfaqësuesit e organizatave të personave me nevoja të veçanta kërkuar përkrahje më të madhe nga Qeveria për këto kategori, përmirësimin e infrastrukturës ligjore, si dhe zbatimin e ligjeve aktuale që rregullojnë çështjet e personave me nevoja të veçanta.

Kryeministri Mustafa u zotua se të gjitha shqetësimet e ngritura të trajtohen me seriozitetin më të madh nga Qeveria, dhe që shumë shpejtë në takimin e radhës të Këshillit të jetë prezent dhe të kërkojë llogari dhe përkushtim nga të gjitha ministrinë pasi që roli i shoqërisë civile është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Gjithashtu ky takim u vlerësua edhe nga aktivistët e shoqërisë civile që konsiderohet një fillim i mirë për përmirësimin e bashkëpunimit mes dy sektorëve.

Platforma CiviKos, me një anëtarësi mbi 180 organizatash, është e përkushtuar në krijimin e një ambienti të favorshëm të bashkëpunimit mes shoqërisë civile dhe Qeverisë duke siguruar transparencë dhe gjithpërfshirje në gjithë procesin, dhe do të vazhdojë në ngritjen e zërit në çështjet me interes për sektorin.

## Takimi i Këshillit për Zbatimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017



Më datë 14 Dhjetor 2016 u mbajt takimi i radhës i Këshillit për Zbatim të Strategjisë për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017. Në këtë takim, siç kishte paralajmëruar edhe në konferencën vjetore të Platformës CiviKos, prezent ishte edhe Kryeministri Isa Mustafa.

Kryeministri Mustafa në takimin e Këshillit, theksoi rëndësinë e rolit të shoqërisë civile, dhe tha se si qeveri janë të interesuar të fuqizohet edhe më tej roli i saj. Ai poashtu theksoi se hartimi i strategjisë me shoqërinë civile ka rëndësi në mënyrë që të jetë më efikase dhe më koherente. Për më tepër shtoi se edhe buxheti duhet të implementohet në harmoni me shoqërinë civile, për të pasur transparencë dhe llogaridhënie të fondeve publike.

Valdete Idrizi, bashkëkryesuese në Këshill dhe Drejtoreshë Ekzekutive e Platformës CiviKos, theksoi mungesën e transparencës me fondet publike, mos ndarjen e buxhetit për aktivitete të Këshillit, mungesën e kapaciteteve njerëzore në ZQM, pjesëmarrjen e ulët të zyrtarëve qeveritarë në aktivitete të ndryshme të përbashkëta. Ajo, gjithashtu kërkoi që të gjitha OJQ-të të trajtohen njësoj nga ministritë e linjës. Po ashtu Idrizi kërkoi të bëhet Rregullorja për Financimin e Shoqërisë Civile nga Qeveria.

Në takim u prezentuan edhe raportet nga koordinatorët e grupeve të Këshillit të cilet raportuan edhe të arriturat dhe sfidat e zbatimit të Strategjisë. Në takim u paraqit edhe hapja e platformës online për konsultime me publikun që do të lanohet në Janar të vitit 2017.

## CiviKos organizoi takime konsultative me OSHC-të në Kosovë

Platforma CiviKos, e përkrahur nga Zyra e TACSO-s në Kosovë, ka organizuar ciklin e takimeve konsultuese rreth zbatimit të Strategjisë Qeveritare për bashkëpunim me shoqërinë civile 2013 – 2017, me OSHC-të nga rajonet Ferizaj (07.12.2016), Gjilan (08.12.2016), Mitrovicë (09.12.2016), Pejë (16.12.2016), Prishtinë (2.12.2016) dhe Prizren(15.12.2016).

Ky cikël i takimeve kishte për qëllim diskutohet e zbatimi i deritanishëm i Strategjisë Qeveritare, sfidat dhe arrijet, si dhe nevojat për vazhdimin e një bashkëpunimi më të strukturuar.

Pas prezantimit të raportit të monitorimit nga ana e Platformës CiviKos, gjatë diskutimit dolën rekomandime konkrete rreth strukturimit më të mirë të bashkëpunimit. Në takime janë shprehur shqetësime për vonesat nga ana e Qeverisë në zbatimin e Strategjisë, por gjithashtu u ngritën çështjet e rregullimit të infrastrukturës ligjore për shpërndarjen e fondeve publike, ngritjes së transparencës nga Ministritë, etj. Nga takimet ka dalur si rekomandim që të krijohen edhe nën grupe për të bashkëpunuar me anëtarët e Këshillit në arritjen rezultateve të dëshirueshme.





# Buletini 11

Tetor - Dhjetor 2016

## Aktivitetet tjera të Platformës CiviKos

- Sekretariati i Platformës CiviKos ka marrë pjesë në rreth 75 ngjarje të ndryshme të organizuara nga organaizata anëtare dhe joanëtare, duke dhënë kontributin e saj qoftë përmes pjesëmarrjes në panel apo në cilësinë e diskutuesit. Gjithashtu ka mbajtur takime individuale me organizata anëtare duke ndihmuar dhe ofruar lehtësim në çështjet me interes. Poashtu ka takuar organizata të cilat kanë kërkuar të anëtarësohen, duke njoftuar me punën e CiviKos dhe lehtësuar procesin e aplikimit për anëtarësi.
- Sekretariati i Platformës CiviKos ka organizuar takime me koordinatorët e grupeve të Strategjisë punuar për të diskutuar zhvillimet e fundit në Strategjinë dhe përgatitjet e raportit mbi zbatimin e Strategjisë të cilat Sekretariati i Platformës CiviKos i cili u publikua muajit dhjetor. Poashtu, në vazhdimësi lehtëson dhe koordinon punën e katër grupeve të punës duke lehtësuar komunikimin ndërmjet tyre dhe institucioneve.
- Sekretariati i CiviKos në mënyrë të vazhdueshme ka ndarë informata me organizatat anëtare, projektligjet për konsultime publike, draft dokumentet, mundësi për grante, mundësi për trajnime si dhe ngjarje të ndryshme me kërkesë nga organizatat anëtare. Gjithashtu, është në procesin e mbledhjes së të dhënave nga organizatat anëtare në lidhje me zbatimin e parimeve të Kodit të, raporti i cili do të publikohet në nëntor 2016.

Platforma CiviKos në rrjetet sociale:



[www.civikos.net](http://www.civikos.net)



## Platforma CiviKos në MEDIE



15 Dhjetor 2016  
Zbatimi i Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017 (Rokum Tv)



15 Dhjetor 2016  
Takimi i Këshillit për Zbatim të Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2013-2017 (Tribuna Channel)



15 Dhjetor 2016  
Bashkëpunimi Shoqëri Civile - Shoqëri (KTV)



22 Nëntor 2016  
Konferenca Vjetore e Platformës CiviKos - Bashkëpunimi në mes të Shoqërisë Civile dhe Qeverisë (Tribuna Channel)



21 Nëntor 2016  
Konferenca Vjetore e Platformës CiviKos - Bashkëpunimi në mes të Shoqërisë Civile dhe Qeverisë (RTK)



21 Nëntor 2016  
Konferenca Vjetore e Platformës CiviKos - Bashkëpunimi në mes të Shoqërisë Civile dhe Qeverisë (Tribuna Channel)



21 Nëntor 2016  
Konferenca Vjetore e Platformës CiviKos - Bashkëpunimi në mes të Shoqërisë Civile dhe Qeverisë (Rokum TV)



21 Nëntor 2016  
Konferenca Vjetore e Platformës CiviKos - Bashkëpunimi në mes të Shoqërisë Civile dhe Qeverisë (RTK)



21 Nëntor 2016  
Konferenca Vjetore e Platformës CiviKos - Bashkëpunimi në mes të Shoqërisë Civile dhe Qeverisë (KTV)



21 Nëntor 2016  
Konferenca Vjetore e Platformës CiviKos - Bashkëpunimi në mes të Shoqërisë Civile dhe Qeverisë (RTV 21)